



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

## TË DHËNAT MBI NDËRMARRJEN

<b>Emri i NSH</b>	NSH D.L.B. "Lavërtaria-Blegtoria" ("Ndërmarrja")
<b>Emri i Ndërmarrjes së Re</b>	<b>Ndërmarrja e Re Lavërtaria-Blegtoria "Drejtoria e vjetër Arbanë" SH.P.K.</b> (Ndërmarrja subsidiare)  Ndërmarrja e Re e ofruar për shitje përfshin vetëm asetin e përshkruar si më poshtë. Asetet e ngelura të Ndërmarrjes nuk ofrohen për shitje, ato do të privatizohen veçmas.
<b>Vendndodhja</b>	Arbanë, Komuna e Prizrenit
<b>Biznesi/Spektori</b>	Agrobiznes/Agrikulturë.
<b>Prodhimet</b>	NSH-ja është ndërmarrje bujqësore e cila përfshin njësinë e lavërtarisë dhe blegtorisë. Aktiviteti i Ndërmarrjes ka qenë i spektrit të gjerë të sektorit të agrikulturës. Ka përfshirë prodhimin dhe shitjen e prodhimeve blegtorale (qumështit dhe plehut), prodhimin dhe shitjen e materialit për mbarsim për të gjitha llojet e bagëtive, përpunimin primar të prodhimeve bujqësore, prodhimin dhe shitjen e drithërave, prodhimin dhe shitjen e perimeve si dhe prodhimin dhe përpunimin e të gjitha llojeve të farërave.  Njësia "Drejtoria e vjetër Arbanë" – (Ndërmarrja subsidiare) ndodhet në Arbanë, Komuna e Prizrenit .
<b>Tregu</b>	NSH-ja është ndërmarrje bujqësore e cila përfshin njësinë e lavërtarisë dhe blegtorisë. Aktiviteti i Ndërmarrjes ka qenë i spektrit të gjerë të sektorit të agrikulturës. Ka përfshirë prodhimin dhe shitjen e prodhimeve blegtorale (qumështit dhe plehut), prodhimin dhe shitjen e materialit për mbarsim për të gjitha llojet e bagëtive, përpunimin primar të prodhimeve bujqësore, prodhimin dhe shitjen e drithërave, prodhimin dhe shitjen e perimeve si dhe prodhimin dhe përpunimin e të gjitha llojeve të farërave.
<b>Konkurrenca</b>	Tregu i produkteve bujqësore është kryesisht i dominuar prej prodhimeve të importuara. Konkurrenca nga fermerët rajonal është e limituar.
<b>Punonjësit</b>	Nuk ka asnjë punonjës të caktuar për njësinë e Ndërmarrjes.  Ndërmarrja ka përafërsisht 56 punonjës. Menaxhmenti i ndërmarrjes ka informuar gojarisht se 80% e tyre aktualisht është në "pushim me pagesë".

Rr. Pushkatarët nr 9  
20000 Prizren, Kosovë  
Tel: +381 (0)29 226 480  
E-mail: [info@pak-ks.org](mailto:info@pak-ks.org)  
[www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org)

Informatat rreth Ndërmarrjes së Re të prezentuar në këtë Të Dhëna nuk janë të përligjura. Investitorët potencial inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) për të kërkuar dokumentet e tenderit. Ata të cilet dëshirojnë të paraqesin ofertë duhet të llogarisin në hulumtimet e tyre. Investitorët potencial këshillohen të bëjnë verifikimin e të dhënave vet para se të paraqesin ndonjë ofertë ose propozim për tender. Këto të Dhëna janë në dispozicion nën kushtet e përgjithshme në informatat paraprake për informacione të publikut të gjerë për kandidatët e privatizimit, e cila mund të nxirret nga faqja e internetit të AKP-së: <http://www.pak-ks.org>



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

## Ndërtesat dhe tokat

**Ndërmarrja e Re Lavërtaria-Blegtoria “Drejtoria e vjetër Arbanë” SH.P.K.** përfshinë pronën me një sipërfaqe totale prej përafërsisht 33935m<sup>2</sup> (3ha e 39ari e 35 m<sup>2</sup>).

Sipas Certifikatave mbi te drejtat e pronës se paluajtshme, prona e cila është lëndë e këtij tenderi, përfshin ngastrën kadastrale P-71813023-00641-1 me një sipërfaqe totale prej përafërsisht 32882 m<sup>2</sup> (3ha e 28ari e 82 m<sup>2</sup>), prej të cilave 30750m<sup>2</sup> (3ha e 07ari e 50 m<sup>2</sup>) me kulturë arë, 1632m<sup>2</sup> (16 ari e 32 m<sup>2</sup>) me kulturë shtëpi dhe 500 m<sup>2</sup> me kulturë oborr, dhe ngastrën kadastrale P-71813023-00642-6 me një sipërfaqe totale prej përafërsisht 1053 m<sup>2</sup> (10ari e 53m<sup>2</sup>), të cilat shtrihen në Zonën Kadastrale Dushanovë, Komuna e Prizrenit.

**NJOFTIM I RËNDËSISHËM:** Në pronën e NSH KBI Progres – “Drejtoria e vjetër” Arbanë, Prizren, që është lëndë e këtij tenderi, gjenden tri godina/ndërtesa të vjetra, fizikisht të ndara njëra nga tjetra, dhe të cilat janë të banuara.

- **Në ndërtesën e parë** (ndërtesë njëkatshe-përdhes nën të njëjtin kulm) jetojnë 5 familje, 2 prej të cilave janë me vendime (një me vendim për shfrytëzim të banesës, të lëshuar nga NSH PIK “Progres-Export”-Prizren dhe një me kontratë për shfrytëzim të banesës të lëshuar nga NSH “Univerzal”-Prizren). Këto familje janë vendosur në këtë ndërtesë për më shumë se 40 vite sipas vendimit/kontratës së lartëcekur.
- **Në ndërtesën e dytë** jetojnë ( dy banesa nën një kulm – njëra pjesë e ndërtesës është e renovuar rishtas) jetojnë 2 familje të cilat kanë vendime për shfrytëzim të ‘banesës’, të lëshuara nga NSH PIK “Progres-Export” -Prizren.
- **Në ndërtesën e tretë** (ndërtesë dykatshe) janë identifikuar uzurpatorë, pa vendime për shfrytëzim dhe pa dijeni të zyrtarëve të NSH-së.

**NJOFTIM I RËNDËSISHËM:** Nga shitja në këtë tender tërhiqen dhe nuk ofrohen për shitje sipërfaqja e përafërt e shtëpive prej 214 m<sup>2</sup> ( 4 shtëpi) kryefamiljaret e të cilëve kanë vendime / kontrata për shfrytëzim të hapësirës së banimit.

**Blerësi i Ri duhet të ketë parasysh se nuk guxon ta mbyll, të pengoi apo të pamundësoj qasjen e personave të tretë për në shtëpitë e tyre.**

Rr. Pushkatarët nr 9  
20000 Prizren, Kosovë  
Tel: +381 (0)29 226 480  
E-mail: info@pak-ks.org,  
**www.pak-ks.org**

Informatat rreth Ndërmarrjes së Re të prezentuar në këtë Të Dhëna nuk janë të përligjura. Investitorët potencial inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) për të kërkuar dokumentet e tenderit. Ata të cilet dëshirojnë të paraqesin ofertë duhet të llogarisin në hulumtimet e tyre. Investitorët potencial këshillohen të bëjnë verifikimin e të dhënave vet para se të paraqesin ndonjë ofertë ose propozim për tender. Këto të Dhëna janë në dispozicion nën kushtet e përgjithshme në informatat paraprake për informacione të publikut të gjerë për kandidatët e privatizimit, e cila mund të nxirret nga faqja e internetit të AKP-së: <http://www.pak-ks.org>



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

## Detyrimet që do të barten

- (1) Detyrimet e papaguara të NSh-së për tatimin mbi pronë, në lidhje me pronën e patundshme që përbën artikujt e tenderuar, e që janë shfaqur gjatë periudhës prej 12 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri. **(nëse ka)**
- (2) Detyrimet e NSh-së për mallra dhe shërbime (p.sh. borxhet ndaj KEK-ut apo për shërbimet tjera publike apo borxhet ndaj furnizuesve mirëpo duke mos përfshirë pagat, pensionet ose pagesat tjera ndaj apo në emër të punonjësve të NSh-së në kapacitetin e tyre si punonjës), që janë shfaqur gjatë periudhës prej 3 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri, **(nëse ka)**.
- (3) Kosto e furnizimit të mallrave dhe shërbimeve ( duke mos i përfshirë pagat, pensionet ose pagesat tjera për ose në emër të punëtorëve të NSh-se në kapacitetin e tyre si punëtorë) e mbledhur gjatë rrjedhës normale të biznesit që:
  - a. Është mbledhur gjatë periudhës tre mujore që përfundon në datën kur deklarata relevante e transferit ka hyrë në fuqi;
  - b. Që mbetet e papaguar deri në atë datë dhe i ngarkohet biznesit të NSh-së.

## Foto incizimi ajror i Ndërmarrjes së Re



## Informatat

Departamenti i Shitjes  
Agjencioni Kosovar i Privatizimit  
Tel: +381 (0) 38 500 400 ext 1255  
Fax: +381 (0) 38 500 400  
[www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org)

## Dokumentet e ofertimit

Agjencioni Kosovar i Privatizimit  
Rr: Ilir Konushevcu Nr:8  
10000 Prishtinë, Kosovë

Rr. Pushkatarët nr 9  
20000 Prizren, Kosovë  
Tel: +381 (0)29 226 480  
E-mail: [info@pak-ks.org](mailto:info@pak-ks.org)  
[www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org)

Informatat rreth Ndërmarrjes së Re të prezentuar në këtë Të Dhëna nuk janë të përligjura. Investitorët potencial inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) për të kërkuar dokumentet e tenderit. Ata të cilët dëshirojnë të paraqesin ofertë duhet të llogarisin në humultimet e tyre. Investitorët potencial këshillohen të bëjnë verifikimin e të dhënave vet para se të paraqesin ndonjë ofertë ose propozim për tender. Këto të Dhëna janë në dispozicion nën kushtet e përgjithshme në informatat paraprake për informacione të publikut të gjerë për kandidatët e privatizimit, e cila mund të nxirret nga faqja e internetit të AKP-së: <http://www.pak-ks.org>